



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

**Në çështjen juridike të :**

**AC-I-16-0111**

**1.R.T. ,**

**Ankuesit/Paditësi**

**2.RR.T.,**

**3. Z.T.,**

**4.A.T.,**

**5. S.T.**

**6. A.T.**

**7. AA.T.** të gjithë nga Prizreni,

**Kundër:**

**E,** Prizren

**Ankuesja/E paditura Komuna.** Përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit(AKP)** Rr.“Agim Ramadani” 23, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS) i përbërë nga Ilmi

Bajrami, Gjyqtar kryesues, Mr. sc. Sahit Sylejmani dhe Sabri Halili, gjyqtarë duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-III-13-0336 të datës 28 prill 2016 dhe ankesës së paditurës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, Prizren C.nr. 201/07 të datës 09/03/2010 pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26/09/2019, lëshon këtë:

## **A K T V E N D I M**

- 1.** Ankesa e paditësve refuzohet si e pa bazuar.
- 2.** Vertetohet, Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-III-13-0336 të datës 28 prill 2016.
- 3.** Ankesa e të paditurës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, Prizren, C.nr. 201/07 të datës 09/03/2010, hedhet poshtë si e pa pranueshme.
- 4.** Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

### **Rrethanat faktike dhe procedural**

Me datë 08 mars 2007 paditësit R.T. dhe RR.T. si dhe Paraardhësit e paditësit V.T., D.T. dhe M.T., të përfaqësuar nga Z.T., ka parashtruar një padi , në Gjykatën Komunale ne Prizren, ndaj të paditurave Komuna e të cilën e përfaqëson Avokati Publik Komunal , E, për vërtetimin e anulimit te kontratës dhe dorëzimin e paluajtshmërisë me vlerë 50,00 euro. Në padi është theksuar se paditësit kanë qenë pronarë të paluajtshmerive : ngas.kad.nr.6/44 në vendin e quajtur me kulture arë, në sipërfaqe prej 1.50,00 ha, të evidentuara ne fletë posedimi nr.114 ZK G. S, ngastra kadastrale nr. 55 në vendin e quajtur "L" me kulturë arë në sipërfaqeje prej 0,61 ari, të evidentuara ne fletë posedimi nr.230 ZK L. Lënda sipas padisë evidentohet, me nr. C.nr. 201/07.

Më 09/03/2010, Gjykata Komunale në Prizren me Aktgjykim. C.nr. 201/07 aprovoi kërkesën e paditësve R.T., RR.T., Z.T., A.T., S.T.A.T. dhe AA.T. dhe obligoi të

paditurën KBI" E"-Lavërtaria Blegtoria Prizren që paditësve në bazë të trashëgimisë të dorëzohet në posedim dhe shfrytëzim pjesën e ngastrës kadastrale 464/1 vendi i quajtur B në sipërfaqe prej 1.50,00 ari, Lista poseduese nr. 52 Zyra kadastrale S e epërme në masat dhe kufijtë nga Veriu prej 112.0 m. nga jugu prej 117.90 m. nga lindja 134.60 m. dhe nga perëndimi prej 149.5 m. si dhe të lejojë regjistrimin e pronësisë në emër të paditësve si bashkëpronar dhe atë në emër të R.T., pjesën ideale prej 6/24, RR.T. pjesën ideale prej 6/24, Z.T., , S.T.A.T. secili nga 2/24 të pjesës ideale A.T. dhe AA.T. secili nga 3/24 të pjesës ideale si dhe të lejoj regjistrimin në librat publik kadastral.

Më 21/04/2010, kundër Aktgjykimit të Gjykatës komunale në Prizren, C.nr. 201/07. të datës 09/03/2010 AKP-ja parashtroi ankesë të afatshme në gjykatën Supreme. Sipas AKP-së Gjykatat Komunale e ka vendosur në mungesë të juridiksionit. Sipas nenit 4.1 (c) të rregullores nr. 2008/4 kompetente për gjykimin e kësaj çështje është Dhoma e Posaçme. Andaj kërkoi nga gjykatat që të anuloj Aktgjykimin ndërsa padinë e paditësve të hedh poshtë si të pa pranueshme.

Nëpërmjet aktit përcjellës Gjykatat e Qarkut në Prizren më datën 30/03/2011 shkresat e lëndës i përcjell për në Dhomën e Posaçme.

Lënda evidentohet si SR-11-0013 .Më 25/07/2012 DHPGJS-ja pranon juridiksioni për çështjen në fjalë. Lënda evidentohet si C-III-12-0336.

Më datën 08.07.2011, Gjykata Komunale ne Prizren, merr Aktvendim C.NR.180/07 me të cilin shpallet inkompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur në këtë çështje juridike, dhe shkresat e lëndës i dërgohen DHPGJS-së si Gjykatë kompetente që është.

Me 26/07/2013, nëpërmjet urdhrin lënda dërgohet në Kolegjin e Apelit për shqyrtim

Në Kolegjin e Apelit lënda, evidentohet si AC-II-17-0011.

Ndaj padisë më datën 25.04.2014, AKP-ja jep përgjigje me të cilën në tërësi e kundërshton padinë dhe pretendimet e tyre si të pabazuar në ligj dhe se ka parashtruar padi në kundërshtim me parimin procedural: legjitimacion ad causam,

dhe i propozon Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ta aprovoj mbrojtjen si të bazuar, ta hedhë poshtë padinë si të papranueshme, ose ta refuzoj si të pabazuar në ligj.

Më datën 21.05.2014, Paditësi R.T. ka paraqitura përgjigje kundër përgjegjës se AKP-se, duke kundërshtuar në tërësi pohimet e cekura në përgjigjën e paditurës AKP pasi që nuk i ka vërtetuar pohimet e cekura në përgjigjën në padi, dhe se ka dorëzuar të gjitha provat të cilat vërtetojnë legjitimitetin e tyre aktiv.

Më datën 27.04.2016 , DHPGJS-ja, merr Aktvendim, dhe hedh poshtë padinë si të papranueshme, për arsye se nuk është dorëzuar vendimi trashëgimie nga paditësi, posaçërisht për paraardhësin e tij të ndjerë ,V.D.dhe M.T..

Më datën 25.05.2016, Paditësi Z.T. ka paraqitur ankesë për shkak të konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendje faktike, zbatimi i gabuar i së drejtës materiale dhe kërkon nga Kolegji i Apelit ta rishikojë Aktvendimin e DHPGJS C-III-12-0336 të njëjtin ta anuloj dhe lëndën ta kthej Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje. Ankesës ia ka bashkangjitur edhe Çertifikata e vdekjes së R.T., A.T., H.T., R.T., S.T.

Më datën 27.06.2016, jep përgjigje me të cilën në tërësi e kundërshton ankesën të parashtruar kundër Aktvendimit të ankimuar ,duke i konsideruara si të pabazuar në ligj.

Më 06/08/2018 nëpërmjet të urdhrit të brendshëm gjyqtari i çështjes Lëndën e evidentuar me nr. AC-II-17-0011 ia bashkon lëndës AC-I-16-0111. Me arsyetim se nga të nijetit paditës kundër të njëjtës të paditur me objekt të njëjtë në DGJS-evidentohet edhe një lëndë me një numër tjetër dhe për hire të ekonomizimit lënda duhet të bashkohet.

Më 06/12/2018, Kolegji i Specializuar nëpërmjet urdhrit kishte kërkuar nga ankuesit që në Dhomën e Posaçme të parashtrorjës, Aktvendimin, mbi Trashëgimin për ankuesit me të cilin vërtetohet se ata janë trashëgimtarë të R.T., R.T., H.T., S.T., A.T.. Në pajtim me nenin 24 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e

Posaçme të deklarohen për përfaqësuesin e tyre apo të deklarohen se përfaqësojnë vetveten.

Deklarata duhet të mbështetet me dëshmi: Autorizim apo deklarata të nënshkruara nga të gjithë paditësit dhe të vërtetuara nga Noteri.

Nëse ankuesit nuk i ofrojnë dëshmitë e kërkuara në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të urdhrit, Dhoma Posaçme do ta refuzoj ankesën si të pa bazuar.

Në përgjigjen ndaj urdhrit, parashtruan vetëm Aktvendimi i trashëgimisë së R.T., LRP nr.3486/2016 ,T.nr. 856/2016 sipas të cilit ,vërtetohet se trashëgimtarë të R.T. janë N.T., B.T., BB.T., B.R.T., N.T., , që të gjithë –bashkëshortja, bijtë dhe bijat e trashëgimlënësit, trashëgojnë tërë masën e pasurisë trashëgimore të lënë nga ana e trashëgimlënësit, në mënyrë të barabartë(1/5). Nuk janë parashtruar Aktvendimet mbi trashëgimin për ankuesit e tjerë.

### **Arsyetimi ligjor:**

Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës, në bazë të nenit 69 par.1 i Ligjit nr.06/L-086 për DHPGJS të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

### **Lidhur me ankesën e paditësve**

Ankesa është e pabazuar .

Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Në rast të një padie në lidhje me të drejtat mbi një pasuri të trashëguar, Gjykata duhet të shqyrtojë ex officio nëse të gjithë trashëgimtarët janë të përfaqësuar. Aktvendimi i Trashëgimisë është dokument i vetëm për të treguar dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pozitën trashëgimore dhe duhet të kërkohet nga paditësit sa më parë që lind ndonjë dyshim se jo të gjithë trashëgimtarët janë të përfaqësuar

si paditës për rastin në fjalë. Nëse Aktvendimi i Trashëgimisë nuk është paraqitur brenda afatit të arsyeshëm, padia duhet hedhur poshtë si e papranueshme.

Legjitimiteti aktiv i paditësve megjithatë është kundërshtuar nga e paditura duhet të shqyrtohet menjëherë sepse kjo do të jetë një humbje e kohës dhe burimeve që të shkojë më tej për aq kohë sa nuk është e qartë nëse paditësi mund të jetë bartës i së drejtës që ai e pretendon. Nëse ai nuk mund të jetë bartës i së drejtës të cilën e pretendon atëherë padia duhet të hedhet poshtë si e pa pranueshme.

Në këtë lëndë Kolegji i Apelit vëren se paditësit nuk e kanë rregulluar çështjen e trashëgimisë. Ankuesve i është dhënë mundësia nga ana e gjykatës, përmes urdhrit të pranuar me datë dt. 11/12/2018 të dërgojë Aktvendimin e trashëgimisë për të vërtetuar legjitimitetin e tyre aktiv, mirëpo i autorizuari i tyre ka dështuar ta dorëzojnë këtë dokument. Në vend të Aktvendimit ai ka parashtruar, aktvdekjen si dhe Certifikatat e lindjes së trashëgimtarëve.

Kolegji i Apelit vlerëson se Aktvendimi Trashëgimisë është i vetmi dokument në bazë të nenit 171.1 lidhur me nenin 178.1 të Ligjit për procedurën jo kontestimore, i cili e vërteton legjitimitetin e aktiv në procedurë.

Është e vërtetë që i autorizuari i ankuesve në procedurën para Kolegjit të Apelit ka dorëzuar aktvdekjen si dhe Certifikatat e lindjes së trashëgimtarëve mirëpo me dokumente të tilla nuk mund të vërtetohet legjitimiteti i kontestuar i paditësit në procedurë.

Për më tepër i autorizuari nuk është deklaruar as lidhur me përfaqësimin sipas nenit 25 të Shtojcës së ligjit për DHPGJS-së.

Në bazë të arsyeve të cekura ankesa e paditësve, refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet, Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Lidhur me ankesën e AKP-së**

Ankesa hedhet poshtë si e pa pranueshme

Kolegji i Apelit konsideron se ankesa e të paditurës, mbetet pa objekt lëndor kontestues pas vërtetimit të Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar, C-III-13-0336 të datës 28 prill 2016 me të cilin padia e paditësve ishte hedhur poshtë si e pa pranueshëm për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv.

Kolegji i Apelit duke vepruar sipas ankese së paditësve kundër Aktvendimit të lartë cekur refuzoi ankesën si të pa bazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e ankimuar.

AKP-ja nuk ka më interes ligjor për të ndjekur çështjen në fjalë prandaj ankesa e saj kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale Prizren C.nr. 201/07 të datës 09/03/2010 duhet të hedhet poshtë si e pa pranueshëm.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

#### **Taksat gjyqësore:**

Ankuesi është përgjigjur në urdhrin e Gjykatës lidhur me shpenzimet gjyqësore, duke paguar më 06/06/2016, shumën prej 100 euro për parashtrimin e ankesës në procedurën ankimore.

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 26/09/2019 .

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues,

#### **URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT:**

Ju lutem dërgojeni këtë Aktvendim tek:

- Ankuesit,

- E paditura,
- Gjyqtarit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, në lëndën C-III-12-0336.
- Gjyqtarit të Gjykatës themelore Prizren në lëndën C.nr. 201/07 të datës 09/03/2010.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_